5773/1
24.12.2024

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
**BASHKIA GRAMSH**
**KESHILLI BASHKIAK**
**KOMISIONI I FINANCAVE, EKONOMISE DHE PASURIVE PUBLIKE VENDORE**

RAPORT VENDIMARRJE

Nr.1, Datë 24./12./2024

Lënda: Vendim për shqyrtimin e projekt-vendimit nr.5746/1,datë 20/12./2024 "Projekt vendim mbi Miratimin e Buxhetit të vitit 2025 dhe PBA-së 2025-2027"

Drejtuar: Këshillit Bashkiak Gramsh

Hyrje

Ky projekt-vendim paraqitet nga Drejtoria e Finance dhe Buxhetit,të Bashkisë Gramsh Sektori i .Buxhetit , dhe ka për qëllim:

| | |
|---|---|
| BAZUESHMERIA LIGJORE DHE VOTIMI | *Hartimi i projektit buxhetor afatmesëm 2025 - 2027 është bërë bazuar në ligjin nr.139/2015, Për vetëqeverisjen vendore, të ndryshuar, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008, Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë, i ndryshuar , ligjin nr.10296, datë 8.7.2010, Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, ligjin 68/2017 date 27.4.2017, Per financat e veteqeverisjes vendore, udhezimit të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018, Për procedurat standarte te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem te NJQV, udhezimit plotesues nr. 3 date 28.02.2024 të Ministrise se Financave dhe Ekonomisë, Per pergatitjen e programit buxhetor afatmesem vendor 2025 – 2027, dhe dhe shtojcat plotesuese (Shtojcat nr.1 Parashikimi i transfertes se pakushtezuar per bashkite e qarqet per periudhen 2025 - 2027; Shtojca nr.2 Relacioni i përgatitjes se programit buxhtor afatmesem vendor 2025 - 2027; Shtojca nr. 3 Treguesit kryesor makroekonomik e fiskale per periudhen 2025 - 2027; Shtojca nr. 5 Metodologjia e re per bashkite pilot; Shtojca nr. 7-8 shtpojca nr. 7 dhe 8 – Detyrat e sugjeruara dhe afatet e brendshme per miratimin e PBA; Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 23 datë 30.07.2018 "Për procedurat standarte të përgatitjes së programit buxhetor afatmesem të NJQV; Udhëzimit të* |

| | |
|---|---|
| | *Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 9 datë 20.03.2018 Për procedurat standarde të zbatimit te buxhetit, te ndryshuar; Shkreses se Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr. 14088 datë 28.10.2024. Dergohet per njoftim Transferta e Pakushtezuar e Pergjithshme per vitin 2025; Per miratimin e kalendarit te pergatitjes se programit buxhetor afatmesem 2025 - 2027 dhe buxhetit vjetor 2025 te Bashkise Gramsh..* |
| SITUATA AKTUALE E FUNKSIONIT | *Të ardhurat nga burimet qendrore, jane dominuee dhe përcaktuese në strukturën dhe performancën e të ardhurave totale. Varësia financiare nga transfertat ndërqeveritare bën që planifikimi i investimeve kapitale të jetë subjekt i kushtëzuar pothuajse tërësisht nga vendimet e qeverisë qendrore. Pavarësia financiare e Bashkisë Gramsh, matur si raport i të ardhurave të veta vendore ndaj të ardhurave totale, rezulton mesatarisht 20.4 % për trevjeçarin 2025 - 2027. Niveli i të ardhurave vendore përcaktohet në masën më madhe nga performanca e taksave dhe tarifave vendore.* |
| SITUATA FINANCIARE (Impakti financiar, shtesa pakësime në buxhet) | *Të ardhurat e veta vendore per vitet 2025 - 2027, zënë mesatarisht 20.4% të totalit të buxhetit. - 2024:110470 mijë lekë – 2025 165488 mijë leke*<br>*- Transferta e pakushtëzuar per vitet 2025 - 2027 zë mesatarisht 41.4 % të totalit të buxhetit. - 2024: 286762 mijë lekë - 2025:30111mijë lekë (41.40%) - Mesatarja 2025-2027:213952 mijë lekë (+9.20% krahasuar me 2024)*<br>*- Transferta e pakushtëzuar sektoriale per vitet 2025 - 2027 zë mesatarisht 28.2 % të totalit të buxhetit. - 2024: 179994mijë lekë - 2025:213378 mijë lekë (+18.50%) - Mesatarja 2025-2027:213952 mijë lekë (+18.80% krahasuar me 2024)*<br>*- Totali i shpenzimeve te personelit per vitin 2025 është 38127 mijë lekë dhe zë 50.1 % të totalit të shpenzimeve , per vitin 2026 është planifikuar 38127 mijë lekë dhe ze 50.1 % te shpenzimeve dhe per vitin 2027 është planifikuar 38127 mijë lekë dhe ze 48.4 % të totalit të shpenzimeve dhe zënë mesatarisht 50. % të totalit të shpenzimeve.*<br>*- Totali i shpenzimeve operative per vitin 2025 është 177441 mijë lekë, per vitin 2026 është planifikuar 187040 mijë lekë dhe per vitin 2027 është planifikuar 193178 mijë lekë dhe zënë mesatarisht* |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
KESHILLI BASHKIAK
KOMISIONI I FINANCAVE, EKONOMISE DHE PASURIVE PUBLIKE VENDORE

| | |
|---|---|
| | *36.5 % të totalit të shpenzimeve.*<br>- *Totali i transfertave ku perfshihen edhe fondi rezerve dhe fondi i kontigjences per vitin 2025 është 21964 mijë lekë, per vitin 2026 është planifikuar 22655 mijë lekë dhe per vitin 2027 është planifikuar 103375 mijë lekë dhe zënë mesatarisht ........ % të totalit të shpenzimeve.* |
| DREJTORIA PËRGJEGJËSE | *Drejtoria e Finance Buxhetit* |
| RAPORTIMI DHE MONITORIMI | *Komisioni i Financave, Ekonomise, dhe Pasurive Publike Vendore, dhe të gjithë këshilltarët do të monitorojnë zbatimin e buxhetit dhe do të thërrasin sa herë të jetë nevojshme Drejtorinë e Financave dhe Buxhetit dhe Drejtorinë përgjegjëse për zbatimin e projekteve të caktuara.* |
| IMPAKTI SOCIAL DHE GRUPET QË PREKEN | *PBA 2025-2027 dhe Buxheti Vjetor per vitin 2025 ndikon ne jetën të gjitha shtresave, kategorive dhe zhvillimin e të gjithë territorit të Bashkisë Gramsh.* |
| KONSULTIMI PUBLIK | *Janë zhvilluar konsultimet publike me Banorëte të gjitha Njësive Administrative, Kryetarët e Fshatrave dhe përfaqsues të grupeve të ndryshme te interesit. Dëgjesat janë mbajtur sipas kalendarit të dëgjesave aprovuar nga Keshilli Bashkiak, publikuar ne faqen e internetit te bashkise Gramsh/rubrika Keshilli dhe të publikuar në rregjistrin e konsultimeve me publikun.* |

Komisioni i Përhershëm i Financave, Ekonomise dhe Pasurive Publike Vendore, i mbledhur më datën 24/12/2024 ora 10:00 pasi shqyrtoi Projekt-vendimin për miratimin e Projekt Aktit Miratimin e e Buxhetit për vitin 2025 dhe PBA-së 2025-2027, relacionin dhe dokumentat shoqërues të tij, paraqitur nga Kryetari i Bashkisë

Komisioni me shumicë votash,

VENDOSI:

1. **Ti propozojë Këshillit Bashkiak raportin pa asnjë ndryshim të relacionit**:

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.

a. Kalimin e projekt aktit në mbledhjen e këshillit për vlerësim të mëtejshëm për vlerësim dhe miratim.
b. Miratimin e projektaktit
c. Refuzimin e miratimit të Projektaktit
d. Ti kerkoje drejtorise perkatese informacion shtese per projektvendimin
e. Miratimin e projektaktit me ndryshimet si vijon:
   - Pika ...... e projektvendimit të ndryshojë në "____________"
   - Pika ........ e projektvendimit të ndryshojë në"______________"
   - Tabela ...... e projektvendimit të ndryhsojë në"____________"
   - Paragrafi ......... i projektvendimit të ndryshojë në "______"

Bashkëlidhur argumentat e Vendimarrjes dhe mendimi i pakicës i parqitur në procesverbalin e Komisionit

Kryetari i Komisionit: Alfrida Shahini

Sekretari i Komisionit: Erald Çarçiu

Anetar i Komisionit: Kujtim Brahimi

Anetar i Komisionit: Ramazan Braho

Anetar i Komisionit: Erisa Zogu

Gramsh, më: 24/...12./2024